



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.04.2021

Nr: 290

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VAU DEJËS, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË, Z. GANI BAHRI ZAGANI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 188 prot., datë 13.01.2021, këshilli i bashkisë Vau Dejës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Florida Rrok Ndoja, propozuar nga partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar kandidatin me numër rendor 22, 23 dhe 25 me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidat vijues nga lista shumëmemërore e partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vau Dejës të cilit i kalon mandati i këshilltarit.

Brenda afatit të përcaktuar ligjor asnjë nga kandidatët e mësipërm, nuk depozitoi formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.



Data: 23.04.2021

Nr. 290

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z.Gani Bahri Zagani.

Duke qenë në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vazhdoi procedurën me kandidatin e rradhës të listës shumemërore të partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vau Dejës.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vau Dejës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 27, z. Gani Bahri Zagani.

Me shkresën nr. 3442 prot., datë 08.04.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatis për anëtar në këshillin e bashkisë Vau Dejës, z. Gani Bahri Zagani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2155 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatis për anëtar, z. Gani Bahri Zagani, në këshillin e bashkisë Vau Dejës, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 3892 prot., datë 16.04.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3893 prot., datë 16.04.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, z. Gani Bahri Zagani, në këshillin e bashkisë Vau Dejës, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Vau Dejës, z. Gani Bahri Zagani.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 4066/1 prot., datë 20.04.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Gani Bahri Zagani, në këshillin e bashkisë Vau Dejës, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.



Data: 23.04.2021

Nr. 290

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Gani Bahri Zagani.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar z. Gani Bahri Zagani, në këshillin e bashkisë Vau Dejës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

V E N D O S:

1. Z. Gani Bahri Zagani, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Vau Dejës, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Gani Bahri Zagani.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 23.04.2021

Nr. 290

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Gani Bahri Zagani.